

RAPORT MONITORIMI

2021 - 2023

GRANTET &
SUBVENCIONET
NGA
MINISTRIA E
BUJQËSISË,
PYLLTARISË DHE
ZHVILLIMIT
RURAL

RAPORT MONITORIMI

2021 - 2023

GRANTET &
SUBVENCIONET
NGA
MINISTRIA E
BUJQËSISË,
PYLLTARISË DHE
ZHVILLIMIT
RURAL

Autori: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Programi: Qeverisje Demokratike

Publikuar: Maj, 2024

Projekti “Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.



PËRMBAJTJA

HYRJE	6
METODOLOGJIA	7
THIRRJET E MONITORUARA	8
Programi për Zhvillim Rural 2020/2021	9
Programi për Zhvillim Rural 2022	12
Programi për Zhvillim Rural 2023	15
Thirrja për Pagesa Direkte 2023	18
REKOMANDIMET TË CILAT KANË GJETUR ZBATIM	22
REKOMANDIMET TË CILAT NUK KANË GJETUR ZBATIM	26
PËRFUNDIME	27

HYRJE

Konzorciumi i organizatave të shoqërisë civile përbërë nga Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS), Insitiuti GAP (GAP) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) janë duke e zbatuar projektin **CorrWatch: "Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikqyrjen dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës"**. Ky projekt, i financuar nga Zyrja për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Jashtëm (FCDO) përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë, shquhet si një nismë kritike brenda Kosovës me qëllim kryesor promovimin e qeverisjes të mirë duke nxitur rritjen e transparencës, forcimit të mbikqyrjes dhe përgjegjësisë nga institucionet publike.

Duke përdorur një qasje aktive dhe retroaktive, të tri organizatat zbatuese janë duke monitoruar një numër të caktuar të institucioneve qeveritare dhe agjencive të pavarura përgjatë pesë komponenteve kyçe:

1. Rekrutimi në administratën publike
2. Praktikat e prokurimit publik dhe menaxhimin e kontratave
- 3. Shpërndarjen e granteve dhe subvencioneve**
4. Dhënien e lejeve, licencave dhe tarifave
5. Performancën dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), është duke e monitoruar procesin e grantdhënies nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Ndonëse CorrWatch gjeti zbatim në qershor të vitit 2022, INDEP ka vazhduar me hulumtimet dhe mbledhjen e të dhënave përfshirë thirrjet e hapura të viteve të mëparshme 2020/2021 dhe vitin 2022. Këto të dhëna, burojnë nga informatat e publikuara nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), si dhe nga raportet vjetore të publikuara nga ministria në fjalë. Për t'i bërë ato sa më të qarta për lexuesin, ato janë vizualizuar duke reflektuar në mënyrë të qartë gjetjet dhe shkeljet ligjore të hasura gjatë monitorimit të thirrjeve. Gjithashtu, në këtë raport të monitorimit janë të përfshira të gjitha veprimet dhe aktivitetet e realizuara përgjatë zbatimit të projektit, përfshirë progresin e arritur dhe pengesat e hasura gjatë monitorimit në tërësi. Në fund të raportit, janë listuar rekomandimet që kanë gjetur zbatim në draftimin e Programeve për Zhvillim Rural, si dhe kriteret e reja të shtuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të gjithëpërfshirjes si dhe monitorim më të thellë të thirrjeve për grante. Në këtë mënyrë, CorrWatch tenton të mbaj të informuar qytetarët rreth masave për përfitimin e fondeve mbështetëse si dhe rreth ndryshimeve të mundshme përgjatë thirrjeve të hapura, duke nxitur kështu rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe jo vetëm nga institucionet publike.

METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti të monitorimit, INDEP ka mbledhur dhe trajtuar një varg të gjerë burimesh të të dhënave dhe dokumenteve relevante që trajtojnë sektorin e bujqësisë. Përpos kësaj, kjo analizë e hollësishme, i prin shfrytëzimit të listave të përfituesve të granteve të ndara nga MBPZHR, bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet konzorciumit CorrWatch dhe ministrisë në fjalë. Në këtë mënyrë, monitoruesit nga INDEP kanë patur të mundur të identifikojnë dhe të dokumentojnë gjetjet e tyre përgjatë zbatimit të Programit për Zhvillim Rural gjatë periudhës 2020-2023.

Përmbledhja dhe krahasimi i të dhënave si:

- Emri i kompanisë përfituese,
- Komuna në të cilin përfituesi/ja ushtron aktivitetin e tij/saj bujqësor,
- Shuma e miratuar për mbështetje,
- Data e regjistrimit të biznesit,
- Kapitali në euro,
- Aktivitetet primare të biznesit përfitues,

kanë ofruar një pasqyrë të qartë dhe më të detajuar të situatës të tanishme. Rrjedhimisht, këto statistika na kanë mundësuar të arrijmë në përfundime me qëllim të rishikimit dhe përmirësimit të politikave aktuale në fushën e bujqësisë.


INDEP, gjithashtu ka takuar dhe intervistuar aktivistë, aplikantë dhe përfitues të fondeve mbështetëse, si dhe përfaqësues nga niveli qendros dhe zyrtarë komunalë, për të marrë perspektivën e brendshme mbi procesin e ndarjes së granteve dhe subvencioneve. Përmes këtyre intervistave, janë identifikuar sfidat të cilat paraqiten kryesisht si shkak i mungesës të digjitalizimit të thirrjeve për mbështetjeve financiare. Për më tepër, njohuritë e përmbledhura nga monitorimi aktiv përgjatë Thirrjes për Grante të vitit 2023 dhe pjesëmarrjes aktive vullnetare të Thirrjes për Subvencione hapur nga komuna e Prishtinës, kanë kontribuar në përpilimin e një raporti të pasur dhe të plotë monitorues, duke ofruar një analizë të hollësishme të dorës së parë dhe rekomandimeve konkrete për zbatimin e një thirrje të suksesshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente.

THIRRJET E MONITORUARA

Në periudhën nga shtatori 2022 deri në mars 2024, INDEP ka monitoruar në detaje katër thirrjet e mëposhtme përfshirë vizitat në terren. Me fokus të veçantë në përmirësimin e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit, gjetjet për çdo thirrje të monitoruar janë prezantuar në mënyrë të pavarur dhe të qartë, duke e analizuar veçmas secilën. është e rëndësishme të theksohet se, të gjitha gjetjet janë të bazuar ekskluzivisht në hulumtimet e kryera përmes platformave të ndryshme dhe përputhshmërisë së tyre kundrejt kriterëve të parashtruara në PZHR. Saktësia e tyre, mbetet të vërtetohet nga organet e larta të drejtësisë në bashkëpunim me Divizioni për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim për Zhvillimin Rural nga Ministria e Bujqësisë.

A E DINI SE?

Monitoruesit nga konzorciumi CorrWatch, janë të parët dhe e vetmja palë nga shoqëria civile që në cilësinë e vëzhguesit kanë monitoruar thirrjet për grante në nivel qendror dhe në atë komunal!



PROGRAMI PËR
ZHVILLIM RURAL
2020/2021
KORRIK 2020



THIRRJA PËR PAGESA
DIREKTE – PËR LOPË
QUMËSHTORE, DELE DHE DHI
MARS 2023

QERSHOR 2022



PROGRAMI PËR
ZHVILLIM RURAL
2022

NËNTOR 2023




PROGRAMI
PËR ZHVILLIM
RURAL 2023

1

KORRIK 2020


**PROGRAMI PËR
ZHVILLIM RURAL
2020/2021**

MONITORIM RETROAKTIV






Lista e përfituesve gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Ky regjistër, përmban të dhëna mbi identitetin e përfituesit, masën për të cilën ka aplikuar, shumën e miratuar në total, shumën për pagesë nga përfituesi si dhe shumën e autorizuar.



Prej 304 bizneseve përfituese, 89 apo 27% prej tyre **nuk figurojnë në faqen zyrtare të ARBK-së** apo në ndonjë platformë tjetër ku mund të informohemi mbi historikun e biznesit të tyre. Sipas Programit për Zhvillim Rural 2020/2021, Pika 7. Kriteret e Veçanta të Pranueshmërisë 7.1 Nënsektorët e përpunimit të qumështit dhe të mishit: Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës së paku dy vjet para datës së aplikimit, dhe i aprovuar nga AUV së paku dy vjet para datës së aplikimit.



Identiteti i 36 përfituesve nuk është i njohur. Në listë figuron vetëm emri i biznesit përfitues por jo edhe i personit fizik.



14 përfitues kanë shuar bizneset e tyre ndonëse kanë fituar grant në vitin 2021. Sipas Programit për Zhvillim Rural 2020/2021, Pika 16. Kontrollat Ex-post: "Të gjitha projektet e përkrahura me Programin e Zhvillimit Rural u nënshtrohen kontrollit Ex-post për një periudhë 3 vjeçare. Gjatë kësaj periudhe, AZHB-ja duhet të bëjë kontrole për të verifikuar respektimin e kriterëve të pranueshmërisë. Gjatë kësaj periudhe, përfituesi është i obliguar të mirëmbajë investimin dhe t'u ofrojë qasje zyrtarëve në rast të kontrollit. Në rast të mosrespektimit të zbatimit të projektit sipas kontratës nga ana e përfituesit, AZHB-ja është e obliguar që të kërkojë nga përfituesi pjesën e bashkëfinancimit nga programi (paranë publike)".



32 prej 304 përfituesve total nuk kanë patur qarkullim vjetor, ndonëse kriter për përfitim të granteve është dëshmia e gjendjes së përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK mbrenda dy viteve.



15

prej tyre si "Aktivitet
Primar të Biznesit" kanë
regjistruar aktivitete të
ndryshme si:

Aktivitetet e
specializuara të
dizajnit.



Tregtia me pakicë e
pijeve në dyqane të
specializuara.

Aktivitetet e
specializuara të
dizajnit.



Ndërtimi i
objekteve banesore
dhe jobanesore.

Përfundimi dhe
finalizimi i punëve
të tjera të
ndërtesave.



Transporti
rrugor i
mallrave.

Nxjerrja e
zhavorrit dhe
rërës, nxjerrja e
argjilës dhe
kaolinit.




Prodhimi i
konstrukcioneve
metalike dhe
pjesëve të tyre.

Mirëmbajtja
dhe riparimi i
automjeteve.



Tregtia me shumicë e
drurit, materialeve të
ndërtimit dhe pajisjeve
hidrosanitare.

Prodhimi i
veshjeve të
tjera të
jashtme.



Prodhimi i artikujve të
tjerë prej letrës dhe
kartonit.

2

QERSHOR 2022

PROGRAMI PËR ZHVILLIM RURAL 2022

MONITORIM RETROAKTIV






Lista e përfituesve nuk është e publikuar në faqen zyrtare të AZHB-së. Megjithatë, ajo është ndarë me INDEP duke u bazuar në Memorandumin e nënshkruar në mars 2023, nga Konzorciumi CorrWatch dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Me këtë memorandum, përcaktoheshin përgjegjësitë e secilës palë, me synim të bashkëpunimit dhe sigurimit të qasjes së plotë në të dhënat publike, përfshirë pjesëmarrjen aktive të CorrWatch përgjatë thirrjeve për grante dhe subvencione.



PËR DALLIM NGA VITI PARAPRAK, TË GJITHË PËRFITUESIT FIGUROJNË NË FAQEN ZYRTARE TË ARBK-SË



E PËRFITUESVE SI AKTIVITET PRIMAR TË BIZNESIT KANË REGJISTRUAR AKTIVITETE QË NUK I PËRKASIN SEKTORIT BUJQËSOR



E PËRFITUESVE KANË PËRFITUAR MBËSHTETJE FINANCIARE NGA MBPZH-RJA MË SHUMË SE 1 HERË MBRENDIA PERIUDHËS TRE VJECARE

41

prej 473 përfituesve gjithsejtë si "Aktivitet Primar të Biznesit" kanë regjistruar aktivitete të ndryshme jo-bujqësore.

11

prej tyre nuk figurojnë në faqen zyrtare të ARBK-së apo në ndonjë platformë tjetër ku mund të informohemi mbi historikun e biznesit të tyre.

142

prej 473 përfituesve kanë regjistruar biznesin e tyre në vitin 2023, ndonëse thirrja për grante është hapur në vitin 2022.

4

prej tyre kanë shuar biznesin në po të njëjtin vit ne të cilin kanë fituar grant, pra vitin 2022.

37 individ kanë përfituar mbështetje financiare të dyfishtë nga MBPZHR në vitin 2022. Vlera e miratuar për përfituesit në fjalë arrin shifrën prej **2.5 milionë euro!**

Sipas Programit për Zhvillim Rural 2022, Pika 3. Kërkesat e aplikimit për mbështetje: "Aplikuesi mund të aplikojë në masa të ndryshme të programit. Megjithatë, aplikuesi mund të aplikojë **vetëm një herë brenda masës/nën-masës brenda një afati/thirrjeje për aplikim**. Nëse aplikacioni aprovohet, aplikuesi duhet ta përfundojë këtë projekt para se të aplikojë për projektin tjetër". Më tutje, Pika 6.3. Kriteret tjera të pranueshmërisë: "Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse nuk e ka përfunduar investimin paraprak. Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në (3) tri vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB duhet të bëjë një kontroll, në mënyrë që të bëhet verifikimi të projektit të mëparshëm. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe/ose është jofunksional, atëherë kontrata e re nuk mund të lidhet". Në mungesë të një sistemi të fortë monitorimi dhe kontrolli për të verifikuar zbatimin e projekteve para se të aplikohet për projekte të tjera, rrezikohet që disa individë të përfitojnë disa herë nga programi brenda të njëjtës periudhë duke shpërdorur kështu paratë publike.

*** GLV TË PA AKREDITUARA**

Një ndër pesë masat për të cilët aplikantët mund të fitojnë grant është:

Në Programin Për Zhvillim Rural 2022, Pika 5. Përfituesit ceket se GLV – të mund të jenë përfitues (vetëm nëse janë të akredituara nga MBPZHR. Megjithatë, për shkak të aprovimit të mëvonshëm të Programit, MBPZHR nuk ka hapur thirrje për akreditim të GLV-ve. Në anën tjetër, gjatë sesioneve informuese si dhe në PZHR 2022, është bërë e ditur që 0.2 mil. euro janë ndarë për këtë masë. Kjo do të thotë që, edhe pse masat mbështetëse vazhdojnë të prezantohen, aplikuesit potencialë nuk kanë mundësi të përfitojnë, duke krijuar kështu kushte të favorshme për keqpërodrim të fondeve mbështetëse.

Masa 5

Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal QASJA LEADER



3

MARS 2023

**THIRRJA PËR
PAGEJA DIREKTE -
PËR LOPË
QUMËSHTORE,
DELE DHE DHI**

MONITORIM AKTIV




Me vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, CorrWatch është ftuar për të qenë pjesë e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për lopë qumështore, dele dhe dhi në nivel komunal.



Gjatë kësaj thirrje, janë shqyrtuar 237 aplikacione. 20 prej aplikantëve nuk e kanë patur dokumentacionin e plotë. Të njëjtit, janë kontaktuar për të sjellur dokumentet shtesë brenda një periudhe prej 3 ditësh, në pajtueshmëri me komisionin dhe me rregulloren për ndarjen e subvencioneve.



Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve vërejtur se dëshmia (dokumenti përkatës) mbi posedimin e lopëve, deleve dhe dhive, është e vulosur vetëm nga një veterinar i licensuar. Fakti që ka patur keqpërdorime më herët në lidhje me këtë dokument dhe fakti që vetëm një veterinar i ka nënshkruar të gjitha aplikacionet, lë hapësirë për keqpërdorime.



Pas shqyrtimit të aplikacioneve, janë vizituar 37 lokacione ku aplikantët kanë zhvilluar aktivitetin e tyre. Nga kjo vizitë, 7 prej tyre janë refuzuar për shkak të deklarimeve të pasakta. Gjithsejtë, nga vizitat në terren, janë verifikuar dhe deklaruar 1460 krerë lopë qumështore, 2615 krerë dele dhe 766 krerë dhi.



Lista preliminare e fituesve, pas verifikimeve të shumëfishta nga anëtarët e komisionit, është dërguar Kryetarit të Komunës, Drejtorit të Departamentit për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural (DBZHR), si dhe Departamentit të Financave për të realizuar transaksionet për pagesat direkte.





Pas gjetjes nga monitoruesit e CorrWatch, INDEP ka iniciuar kontakte me Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari (AUV) për të adresuar shqetësimin e tyre lidhur me licencimin e veterinarëve. Pas takimeve të shumta me AUV-in dhe zyrtarë të tjerë nga MBPZHR, është konstatuar se në Kosovë mungon një kornizë legjislative bazë për të përcaktuar kriteret dhe kushtet për licencimin e veterinarëve.

Është e rëndësishme që dokumenti mbi posedimin e krerëve në fushën e blegtorisë të nënshkruhet nga veterinarët e licencuar për shkaqe të sigurisë dhe monitorim më të mirëfilltë të procesit. Vulosja e dokumenteve nga personat adekuatë të licencuar, siguron një nivel shtesë të besueshmërisë dhe profesionalizmit, duke ndihmuar në parandalimin keqpërdorimeve të mundshme dhe rritjen e transparencës së procesit të aplikimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Muaj më pas, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBZPHR) ka njoftuar se në bashkëpunim me AUV-in kanë hartuar një udhëzues administrativ që kushtëzon këtë çështje. Rrjedhimisht, pas disa muajve **për herë të parë kanë hartuar Udhëzimin Administrativ për regjistrimin dhe matrikulimin e kafshëve**. Reforma e prezantuar, paraqet një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të menaxhimit të blegtorisë duke lehtësuar kështu identifikimin e tyre në terren.



Ky akt nënligjor, i paraprin lehtësimit të procesit të monitorimit duke kontribuar kështu në parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme të fondeve mbështetëse në sektorin e bujqësisë.

4

NËNTOR 2023

PROGRAMI PËR ZHVILLIM RURAL 2023

MONITORIM AKTIV




Thirrja për grante, në kuadër të Programit për Zhvillim Rural 2023 është hapur në nëntor. Gjatë pesë viteve të fundit, kjo thirrje nuk është vonuar asnjëherë. Korniza aktuale ligjore që rregullon këtë proces përcakton qartë se MBPZHR është e detyruar që të miratojë masat përkatëse **jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë** nga miratimi i buxhetit për vitin përkatës. Duke konsideruar këtë edhe pas analizës së situatës në praktikë, CorrWatch ka vërejtur që një kërkesë e tillë ligjore nuk është respektuar nga Ministria, duke qenë se Programi Kombëtar për Zhvillim Rural **u nënshkrua tetë (8) muaj më pas**.




Kjo praktikë, mund të ketë pasoja serioze në zhvillimin e sektorit të bujqësisë duke vështirësuar përgatitjet e mirëfillta të bujqëve për aplikim të sukseshëm. Hapja e vonuar për aplikim për mbështetje në kuadër të PZHR 2023, reflekton në mungesë të transparencës duke nxitur dyshime rreth mundësisë së keqpërdorimit të parasë publike, ushtrimin e veprimeve të paligjshme gjatë zbatimit të skemë mbështetëse në këtë sektor. Ky shqetësim, është komunikuar me publikun në nëntor të vitit 2023 nga konzorciumi CorrWatch, me shpresë të minimizimit të praktikave të ngjajshme.

CorrWatch është duke monitoruar thirrjen për grante duke marrë pjesë drejtpërdrejt në procesin e shqyrtimit të aplikacioneve. Gjatë monitorimit, është vërejtur se kopjet fizike të aplikacioneve janë shqyrtuar nga zyrtarët në bazë të preferencave individuale. Kjo metodë e vlerësimit të aplikantëve lë hapësirë për ndikime të jashtme, të cilat mund të çojnë në korrupsion dhe përfitime të paligjshme për individët ose grupe të caktuara. Procesin e shqyrtimit të aplikacioneve duhet të jetë transparent dhe bazuar në kritere objektive, për të siguruar që të gjithë aplikantët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.



Për të përmirësuar mënyrën e aplikimit dhe procesin e vlerësimit të aplikacioneve për grante dhe subvencione, si dhe për të garantuar një nivel më të lartë të transparencës në tërë procesin, është shumë e rëndësishme që të digjitalizohet i tërë sistemi zbatues. Kjo do të rezultojë në shqyrtimin e aplikacioneve në kohë më të shkurtër në mënyrë më efektive duke reduktuar mundësinë për gabime të mundshme në vlerësimin e aplikacioneve apo favorizim të tyre.

NDARJA E GRANTEVE
SIPAS GJINISË NË
VITIN 2021




Në kuadër të Programit për Zhvillim Rural 2020/2021, nga një total prej 304 përfituesish të granteve, 186 prej tyre janë burra, ndërsa 118 janë gra. Shprehur në përqindje 62% janë burra dhe 38% gra.

Bazuar në shumën e miratuar prej 29.3 mil. euro gjithsejtë, 18.2 mil. euro janë ndarë për gjininë mashkullore ndërkaq 11.1 mil. euro për gjininë e kundërt.



NDARJA E GRANTEVE
SIPAS GJINISË NË
VITIN 2022



Në kuadër të Programit për Zhvillim Rural 2022, nga një total prej 473 përfituesish të granteve, 322 prej tyre janë burra, ndërsa 151 janë gra. Shprehur në përqindje, 68% janë burra dhe 32% gra.

Bazuar në shumën e miratuar prej 26.3 mil. euro gjithsejtë, 17.9 mil. euro janë ndarë për gjininë mashkullore ndërkaq 8.4 mil. euro për gjininë femërore.



BASHKËPUNIMET

ZYRA E
KRYEMINISTRIT

ZYRA
KOMBËTARE E
AUDITIMIT

AGJENCIA PËR
PARANDALIMIN
E
KORRUPSIONIT

AGJENCIA PËR
INFORMIM DHE
PRIVATËSI

AGJENCIA E
USHQIMIT DHE
VETERINARISË

POLICIA E
KOSOVËS



TAKIME

31



VERIFIKIME NË
TERREN

230



PARAQITJE
MEDIATIKE

20+



LOKACIONE

37



PËRFITUES
TË
VERIFIKUAR

782

ANALIZA TË
NDRYSHME




13



RAPORT
TEMATIK

1



FORUME
TË
AVOKIMIT

2

REKOMANDIMET TË CILAT KANË GJETUR ZBATIM

Programi për Zhvillim Rural 2022

Rekomandimet e CorrWatch

Programi për Zhvillim Rural 2023

01.

Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave dhe derrave), aplikuesit duhet të kenë së paku 10 viça, respektivisht 20 derra në momentin e aplikimit. Por, para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, si dhe këto duhet të dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë.

Të ulen kriteret për aplikim për subvencione dhe grante me qëllim të gjithëpërfshirjes, ku të gjithë bujqit dhe fermerët mund të jenë fitues. Zhvillimi i programeve që kanë një gamë të gjerë të mbështetjes, përzgjedhja e kujdesshme e masave mbështetëse dhe zbatimi i procedurave adekuate gjatë zbatimit të tyre e pasurojnë tregun vendor dhe kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bujqësor. Kjo ndihmon në përmirësimin e jashtëzakonshëm të aftësisë së komunitetit bujqësor për të përfituar nga burimet dhe për të krijuar një ekonomi vendase të qëndrueshme.

Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave dhe derrave), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë viça/derra në momentin e aplikimit. Por, para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça, ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës, të regjistruar në Regjistrin e Identifikimit të Kafshëve ose të vendeve të BE-së, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë.

Aplikuesit, në momentin e aplikimit duhet të kenë së paku:

- 300 pula, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 1500 krerë;
- 300 rosa, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 1500 krerë;

Aplikuesit, në momentin e aplikimit duhet të kenë së paku:

- 300 pula, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 1500 krerë;
- 300 rosa, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 1500 krerë;

Masa 1

Kriteri i ri

Ne rastet kur vlera e aplikuar e projektit është mbi 50,000 euro, atëherë aplikuesi duhet të sjellë dëshmi mbi gjendjen financiare të tij. Në rastet kur aplikuesi tashmë është subjekt i regjistruar juridik, ai duhet që si dëshmi t'i ofrojë Pasqyrat financiare nga viti paraprak. Në rastet kur aplikuesi është person fizik, i njëjti duhet të dëshmojë gjendjen në llogarinë e tij bankare për periudhën e fundit 6 mujore.



Bazuar në rekomandimin vijues, MBPZHR-ja e ka rritur kohëzgjatjen për të cilën përftuesit e granteve janë të detyruar të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së, AZHB-së, Auditorit, organizatave dhe institucioneve të tjera me kërkesë të AZHB-së, nga 3 vite sa ishte në PZHR 2022 në 5 vite pas zbatimit të projektit në PZHR 2023:

02.

Përfituesit janë të detyruar t'i mbajnë të gjitha të dhënat e kontabilitetit në fermë të paktën **tri (3) vite** pas zbatimit të projektit, si dhe të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së për të siguruar çdo informacion të kërkuar nga AZHB-ja apo nga Komisioni Evropian, në rast të shfrytëzimit të fondeve të IPARD-it.

Të kryhen kontrollat të rregullta dhe të hulumtohet tregu pas implementimit të skemës së granteve dhe subvencioneve për vitin përkatës. Kontrollat duhen kryer nga personat autorizues, inspektorë, njohës të sektorit të bujqësisë, si dhe të angazhohen palë të jashtme kontraktuese me qëllim të mbarëvajtjes të procesit. Aktualisht mungojnë të dhënat për rezultatet e synuara dhe nuk ka shënime që pasqyrojnë impaktin e skemave mbështetëse në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Angazhimi i palëve të tjera, përfshirë shoqërinë civile do të siguronte monitorim më rigoroz të matjes së impaktit të fondeve mbështetëse.

Përfituesit janë të detyruar të mbajnë të gjitha dokumentet të paktën **pesë (5) vite** pas zbatimit të projektit, si dhe të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së, AZHB- së, Auditorit, organizatave dhe institucioneve të tjera me kërkesë të AZHB-së. Kushtet e financimit do të përcaktohen më hollësisht në kontratë në mes të përfituesit dhe AZHB-së.

Kriteret e reja

Shpenzimet për tarifat e arkitektëve, inxhinierëve, studime fizibiliteti, apo konsulenca për përgatitjen e planit të biznesit do të jenë të pranueshme vetëm nëse janë kryer nga profesionistë dhe kompanitë të specializuara të fushës. Përfituesi duhet të ofrojë të dhënat e sakta për ekspertin dhe kompaninë që ofron shërbimin.

Si shpenzim i pranueshëm për të gjitha nën-masat do të jetë edhe angazhimi i një studenti në vitin e fundit apo të sapodiplomuarit në fushën e bujqësisë, agroekonomisë apo teknologjisë ushqimore. Vlera e mbështetjes nga MBPZHR do të jetë 2,400 € brenda një viti kalendarik, e dëshmuar përmes kontratës së noterizuar.

Asnjë lloj investimi nuk pranohet të rrefinancohet pa kaluar periudha e amortizimit të plotë të atij investimi (pajisje, makineri, ndërtesa etj.). AZHB-ja duhet të mbajë një listë të investimeve për secilin fermer dhe gjatë vlerësimit të aplikacionit në vitin aktual duhet të nënshtrohet kontrollit të kryqëzuar në dhjetë (10) vite paraprake për investim të njëjtë për përfituesin e njëjtë.

Projekti fillon së implementuari pasi të nënshkruhet kontrata për bashkëfinancim, e cila mund të ketë kohëzgjatje deri në 2 vjet, varësisht nga specifikat e investimit.

Projekti fillon së implementuari pasi kontrata për bashkë-financim të nënshkruhet dhe mund të ketë kohëzgjatje deri në 1 vit, varësisht nga specifikat e investimit.

03.

Të gjitha projektet e përkrahura me Programin e Zhvillimit Rural u nënshtrohen kontrollit Ex-post për një periudhë tri (3) vjeçare.

MBPZHR-ja duhet të sigurohet që gjatë gjithë procesit, shumica e miratuar të shpenzohet brenda kufijëve buxhetor të ndarë për atë vit në përputhje me Programin e Zhvillimit Rural. Për shkak të vonësive në aprovim të programeve dhe hapje të thirrjeve, shpeshherë pagesat po barten për vitin e ardhshëm. Fakti që shumica e ndarë dhe ajo e implementuar granteve dhe subvencioneve asnjëherë nuk përkojnë me njëra tjetrën, vështirëson planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Institucionet kompetente duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë, në rast të dështimit të zbatimit të projektit pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin në fjalë.

Të gjitha projektet e përkrahura me Programin e Zhvillimit Rural u nënshtrohen kontrollit Ex-post për një periudhë pesë (5) vjeçare.



Për të gjithë përfituesit e granteve koha gjatë të cilës do të i nënshtrohen kontrollit Ex-post projektet e përkrahura është rritur nga periudha 3 vjeçare sa ishte e përcaktuar në PZHR 2022 në periudhën 5 vjeçare sipas PZHR 2023.

Ky kriter nuk kanë ekzistuar në Programin për Zhvillim Rural 2022. Ato janë shtuar pas rekomandimeve nga CorrWatch në Programin për Zhvillim Rural 2023.

Të përditësohet si dhe të publikohet lista e zezë e cila përmban emrat e bujqve që kanë qenë të përfshirë në raste të njohura për korrupsion, keqpërdorim të mjeteve. Kjo listë do të përdoret për të caktuar sanksione që do të ndalojnë aplikimin e tyre për subvencione dhe grante për një periudhë prej tre vitesh ose më shumë. Kjo masë ka për qëllim të promovojë sjelljen dhe aktivitetet ligjore në sektorin bujqësor dhe të ndikojë në përmbushjen e rregullave dhe rregulloreve të ndërlidhura.



Këto kritere për herë të parë janë shtuar në kriteret e PZHR 2023, si një formë që do të ndikojë në zvogëlimin e mundësive për keqpërdorime dhe mashtrime të mundshme:

Aplikuesve do të i refuzohen projektet në rast se:

Në rast të mashtrimit në cilëndo fazë të procedurës;

Nëse projekti i financuar nga përkrahja publike nuk është funksional sipas projektit/plan biznesit dhe kontratës;

Në rast mos respektimit të kushteve të kontratës për financim të kontratës;

Aplikuesit të cilët aplikojnë për investime publike gjithashtu do të refuzohen nëse ata dështojnë të kryejnë procesin e prokurimit sipas rregullave të aplikueshme të prokurimit.

Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë 5 viteve pas ekzekutimit të pagesës së fundit nga AZHB. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike.

Kriteret e reja

04.

Këto kritere nuk kanë ekzistuar në Programin për Zhvillim Rural 2022. Ato janë shtuar pas rekomandimeve nga CorriWatch në Programin për Zhvillim Rural 2023.

Gjatë procesit të dhënies së granteve të mëdha, siç janë mjetet bujqësore, është e rëndësishme të implementohet një sistem rotativ ndërmjet përfituesve dhe bujqve, në mënyrë që të sigurohet një përdorim efikas dhe i qëndrueshëm i këtyre burimeve. Ky sistem lejon që bujqit të shfrytëzojnë mjetet për një periudhë të caktuar dhe pasi ata nuk i përdorin ato për arsye të ndryshme, t'i transferojnë tek bujqit tjerë. Kjo ndihmon në maksimizimin e përdorimit të këtyre mjeteve, përmirësimin e produktivitetit bujqësor dhe përkrahjen e komunitetit bujqësor në përdorimin e burimeve të përbashkëta, duke shmangur që ato të mbeten pasive dhe të mos shfrytëzohen për përdorim.

* Për herë të parë në PZHR 2023 si pikë e re është shtuar kriteri se:

Investimet për blerje të traktorit do të pranohen vetëm në ato raste kur ekziston një korelacion i ngushtë ndërmjet madhësisë/fuqisë së traktorit dhe ngarkesës së punës/madhësisë së fermës/kapacitetit prodhues, i prezantuar dhe arsyetuar mirë në planin e biznesit.

* Ky kriter nuk ka ekzistuar më herët dhe do të jetë mjaft profitabil meqë do të ndërlihet direkt kapaciteti prodhues me madhësinë dhe sasinë e mjeteve bujqësore që nevojiten.

Investimet për blerje të traktorit për pemët drufrutore, lejohen vetëm për aplikuesit me sipërfaqet ekzistuese prej 3 (tre) e më shumë hektarësh në momentin e aplikimit.

IVetëm për aplikuesit tre (3) e më shumë hektarë sipërfaqe me në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira, me pemë drufrutore dhe manore, lejohet aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;

REKOMANDIMET TË CILAT NUK KANË GJETUR ZBATIM

01.

Të përcaktohen afate kohore për përgatitjen dhe ekzekutimin e programeve për grante dhe subvencione me qëllim të miratimit të programeve në kohën optimale të të mbjellurave sezonale. Procesi i skemave mbështetëse të granteve përcillet me vonesa që nga aprovimi i tij, hapja e thirrjes, deri tek nënshkrimi i kontratave. Sipas akteve nënligjore kjo kohëzgjatje mund të zgjasë deri në 3 muaj, ndërkaq në realitet, procesi përcillet me vonesa edhe më të gjata. Andaj, është më se e domosdoshme të caktohen afatet kohore për hapjen e thirrjeve për procesin e aplikimit për grante dhe subvencione në periudha saktësisht të njëjta për çdo vit. Marrë parasysh që bujqësia është prodhimtari sezonale, kjo do ta ndihmonte aplikimin e bujqëve për mbështetje për të mbjella në përputhje me planifikimet e gjendjes në terren.

02.

Të kryhen studime dhe analiza rreth mundësive të përshtatshmërisë për kultivimin e kulturave bujqësore. Kulturat e mbështetura jo gjithmonë kanë qenë të përshtatshme për kultivimin në territorin e Kosovës. Kjo mund të orientojë sektorin e bujqësisë drejt kulturave që nuk janë profitabile për tregun tonë apo që nuk i përmbushin kërkesat e tregut. Duhet të kryhen studime të fizibilitetit nga ekspertët bujqësor, rezultatet e të cilave duhet shpalosur me hartuesit e programeve.

03.

Ministria në bashkëpunim me agjencitë përkatëse, duhet të sigurojë të dhëna për të artuar programet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut. Në sektorin bujqësor, ka një mungesë të të dhënave të sakta lidhur me bujqësinë në Kosovë. Është e rëndësishme të disponohen informacione konkrete në lidhje me numrin e bizneseve bujqësore aktive, demografikën e popullatës që jeton në zonat rurale dhe potencialin etyre për punësim në bujqësi. Gjithashtu, është e rëndësishme të kemi njohuri të sakta për numrin e familjeve që janë të varura nga të ardhurat e tyre nga bujqësia dhe sa prej tyre e kryejnë atë si veprimtari shtesë.

04.

Të mitet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe Drejtorive për Zhvillim Rural në nivel lokal. Disa individë ishin përfutës të dyfishtë ndërkaq disa të tjerë janë ankuar që në mënyrë të padrejtë nuk ishin subvencionuar. Ministria duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me komunitat për të koordinuar aktivitetet e ngjashme lidhur me përzgjedhjen e përfutësve në mënyrë që të siguroj që të mos ketë përfutës për masën e njëjtë nga të dy nivelet mbrenda të njëjtit vit. Gjithashtu, AZHB-ja duhet të vendos komunikim të rregullt me palët e treta, qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve sidomos gjatë kohës së thirrjeve publike.

05.

Për të përmirësuar mënyrën e aplikimit dhe procesin e vlerësimit të aplikacioneve për grante dhe subvencione, si dhe për të garantuar një nivel më të lartë të transparencës në tërë procesin, është shumë e rëndësishme që të digjitalizohet sistemi i aplikimit. Kjo do të rezultojë në zvogëlimin e kohës së aplikimit, pritjeve të tepruara të qytetarëve nëpër institucione dhe reduktimin e mundësive për gabime të mundshme në procesin e aplikimit dhe vlerësimit. Digjitalizimi i paraprin monitorimit duke ulur mundësinë për keqpërdorime, duke e bërë të vështirë manipulimin e procesit në mënyrë të parregullt.

06.

Të vendosen mekanizma rregullues me qëllim të mbrojtjes së cmimit në treg. Subvencionimi i produkteve sipas çmimit është një mjet i rëndësishëm për të siguruar qasje të barabartë të çdo qytetari në mallra dhe shërbime të rëndësishme. Ky veprim jo vetëm që ndihmon në luftën kundër varfërisë dhe paqftësisë ekonomike por gjithashtu inkurajon prodhimin vendas dhe përmirëson stabilitetin e tregut. Nëpërmjet subvencioneve të çmimeve, shteti mund të ndikojë në aftësinë e qytetarëve për të patur akses në produkte të nevojshme dhe për të promovuar zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo është një strategji e rëndësishme për të mbështetur mirëqenien e përgjithshme dhe për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

PËRFUNDIME

Grantet dhe subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vazhdojnë të mbesin një ndër çështjet më delikate dhe ndër më të përfolurat që nga prezantimi i tyre në vitin 2009. Pavarësisht investimeve milionëshe dhe rritjes të buxhetit dedikuar fuqizimit të këtij sektori, nuk është hetuar ndonjë rritje e kënaqshme e produktivitetit apo eksportit të të mirave nga ky sektor. Për më tepër, rritja e importit dhe inflacionit në treg, vetëm sa po dobësojnë buxhetin e konsumatorëve dhe vetë ndërmarrësve duke ngelur me cmime të përballueshme në treg për një shumicë të konsiderueshme. Taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe ndihmat e dhuruara nga donatorët e shumtë ndërkombëtarë, në vend që të nxisin një konkurrencë të shëndetshme bujqësore, vetëm sa po e cenojnë atë duke kontribuar në një treg të paqëndrueshëm.

Disa nga sfidat e identifikuar nga konzorciumi CorrWatch përgjatë gjatë monitorimit, përfshirë menaxhimin joefikas të investimeve në infrastrukturën rurale, mospërbushjen e kriterëve nga aplikantët e përzhgjedhur, vlerësim dhe monitorim të cekët si dhe mospërfshirje të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në hartimin e strategjive dhe programeve për zhvillim rural, janë pikatur edhe nga Zyra Kombëtare e Audimit. Edhe pse Ministria ka rregullore dhe plane të qarta që përcaktojnë zhvillimin e aktiviteteve në aspektin kohor dhe procedural, aprovimi i tyre i vonshëm, është duke ndikuar në mbarëvajtjen e rregullte të të tërë procesit përfshirë ekzekutimin e pagesave, procedurë, e cila mund të zgjasë deri në dy vite. Fakti që shuma e ndarë dhe ajo e implementuar e granteve dhe subvencioneve asnjëherë nuk përkon me njëra tjetrën mbrenda një viti kalendarik, vështirëson planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, duke lënë mjaft hapësirë për shpërdorim të parave publike. Aktualisht mungojnë të dhënat për rezultatet e synuara dhe nuk ka shënime që pasqyrojnë impaktin e skemave mbështetëse në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Përderisa e tërë vëmendja është përqendruar tek rritja e transparencës dhe llogaridhënies, politikat e sektorit më me potencial vazhdojnë të mbesin të njëjta, sistemi për aplikim për grante dhe procedurat administrative gjithashtu. Pa një sistem të mirëfilltë monitorimi dhe fuqizim të inspektoriatit, druhemi që ka hapësirë të mjaftueshme për keqpërdorim të parasë publike edhe në ditët e sotme. Ministria e Bujqësisë nuk është duke krijuar mekanizma të mjaftueshëm për monitorimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit në sektorin bujqësor, përfshirë marrjen e masave efektive në parandalimin e rasteve të korrupsionit në bashkëpunim me agjencitë e tjera dhe nivelin komunal. Vetëm në këtë rast, mund të sigurohemi që fondet mbështetëse janë duke u përdorur për të përmbushur nevojat e popullatës duke promovuar një treg bujqësor të drejtë dhe të qëndrueshëm.

Mbështetur nga:

Zbatuar nga:

